



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë 25 . 06 .2025

PROPOZIM PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë _____ .2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, si dhe kërkesës së Znj. Elida Piro Xhindi (Brakaj) për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 602 Prot, datë 21.03.2025,

VENDOSI;

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zonjës Elida Piro Xhindi (Brakaj), për kontributin e çmuar në sportin e Notit dhe rezultatet e shkëlqyera në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë!

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Jurist

Alma Myrtaj

KRYETARI

Ervis Moçka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur Zonja Elida Xhindi (Brakaj), e lindur më 05.03.1962 në qytetin e Vlorës, banuese midis Vlorës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 602 Prot, datë 21.03.2025.

Kërkesa drejtuar institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur, dashurinë për sportin e notit, karrierën e gjatë si dhe arritjet e larta si në arenën kombëtare po ashtu edhe ndërkombëtare.

Zonja Xhindi ka dhuruar emocion dhe spektakël që në moshën 13 vjeçare kur është shpallur kampione kombëtare për herë të parë në të gjitha kategoritë e moshave: pioner, të rinj dhe të rritur. Disa nga këto rekorde janë mbajtur dhe kanë mbijetuar për dekada, duke dëshmuar cilësinë e performancave të saj.

Gjatë karrierës së saj ka konkurruar me sukses në disa disiplina noti, duke përfshirë 50, 100 dhe 200 metra stil i lirë, 100 dhe 200 metra shpinë, 200 dhe 400 metra katërnotim si



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

dhe 200 metra delfin, këto si përfaqësuese e ekipit “Flamurtari”, “Studenti” dhe Ekipit Kombëtar.

E ashtuquajtura “Mbretëresha e Ujit” në moshën 27 vjeçare, ka vendosur një rekord në 50 metra stil i lirë, një arritje që nxori në pah jo vetë talentin e saj, por edhe pasioni dhe përkushtimin e pandërprerë për këtë sport, arritje e rrallë për moshën e saj.

Me disiplinën e saj të hekurt, punën e palodhur, stërvitjen e përditshme, Zonja Elida ka fituar si askush tjetër 5 medalje ari në një aktivitet të vetëm kombëtar.

Rrugëtimi i saj në fushën e sportit nuk ndali edhe kur ishte jashtë ujit, Znj. Xhindi ushtroi profesionin e Mësueses së Edukimit Fizik duke përcjellë në brezat e rinj dashurinë dhe kulturën për sportin.

Me vendosjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Znj. Xhindi ka vazhduar me pasionin e saj, duke ushtruar detyra të rëndësishme si Koordinatore e Departamentit të Notit dhe Trajnere e Ekipit të Notit në Kaliforni, Instruktore e Aerobisë në Ujë, Drejtore e Departamentit të Aerobisë në Ujë dhe Gjyqtare Noti (e nivelit ndërkombëtar).

Kjo sportiste e niveleve ndërkombëtare, “Mjeshtre e Sportit” e vlerësuar maksimalisht për kontributin e saj, edhe sot vazhdon të stërvitet dhe të garojë me ekipin e mjeshtrave duke ruajtur frymën konkurruese.

Bashkëlidhur kërkesës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Jetëshkrimi – Profili profesional;
- Çertifikatë personale, me datë 25.03.2025;
- Çertifikatë familjare, me datë 03.03.2025;
- Çertifikatë martese, me datë 03.03.2025;
- Çertifikatë lindje, me datë 25.06.2007;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë me Nr. 266 Prot, datë 05.03.2025.
- Kopje e noterizuar e Titullit “Mirënjohje e qytetit” dhënë nga bashkia Vlorë, datë 28.04.2018, me motivacion “Për kontribut të shquar në sportin e notit, duke përfaqësuar denjësisht Vlorën me ngjyrat e ekipit të “Flamurtarit”, në vitet 1980-1990. Kampione e rekordeve kombëtare. Është fituese e 5 medaljeve ari në Spartakiadën Kombëtare, duke qenë e vetmja sportiste e Vlorës që ka arritur një rezultat të tillë. Ka thyer rekord kombëtar, për të rritur, në moshën 13 dhe 27 vjeçe, gjë e rrallë kjo për sportin e notit”;
- Kopje e noterizuar e Titullit “Mjeshtër i Madh” dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 12088, datë 07.04.2021 me motivacion “Në shenjë vlerësimi për kontributin dhe rezultatet e larta si notare e talentuar e ekipeve “Flamurtari”, “Studenti” dhe Ekipit Kombëtar. Kampione dhe rekordmene në garat e stilit “Shpinë” dhe stilin “E lirë”, me rezultate të shkëlqyra në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Duke u bazuar në kërkesën e Zonjës Elida Xhindi (Brakaj), në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, mendojmë se kërkesja plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Jurist

Alma Myrtaj